

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.25/11/2024 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues ",
ROLAND DHIMA ,i datelindjes 28/01/1975, i lindur ne Bajkaj dhe banues ne Sarande, Lagjia nr.1, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me nr.038905670, me nr.personal H50128206I leshuar nga MB me date 02/05/2023,i cili me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **KEYSTONE CONSTRUCTION** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **KEYSTONE CONSTRUCTION** shpk. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria **KEYSTONE CONSTRUCTION** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria"). Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria **KEYSTONE CONSTRUCTION** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline ne adresen:

Sarande,Lagjja nr.1, Rruga Butrinti,parcela nr.82,kati 1-re.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- **Investitor ne sektorin e ndertimit,shitblerje te pasurive te paluajtshme.**
- **Hoteleri, turizëm, agjensi turistike, bar, restorante, plazh sporte ujore, import, eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale, artikujve ushqimorë, blegtorale, bujqësore dhe të çdo lloji malli tjetër të lejuar për tregtim, marrëveshje kontraktore me persona fizikë dhe/ose juridikë, vendas dhe të huaj për zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit të përbashkët me to si dhe pjesëmarrja në tendera brenda dhe jashtë vendit, internet, piceri, çadra plazhi, si dhe çdo lloj aktiviteti tjetër të nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi**

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000,000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise. Z. **ROLAND DHIMA**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **10,000,000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit prej **10,000,000 Leke** do te paguhet ne te ardhmen nga ortaku themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku i vetem themelues pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem i cili do te jete:

ROLAND DHIMA, i datelindjes 28/01/1975, i lindur ne Bajkaj dhe banues ne Sarande, Lagjia nr.1, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me nr.038905670, me nr.personal H50128206I leshuar nga MB me date 02/05/2023.

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjecar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet ne cdo kohe dhe per çfare do shkakut, edhe para plotesimit të afatit per të cilin është krijuar siç mund të jete

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë se saj.

b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfare do ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqërisë tregtare **KEYSTONE CONSTRUCTION** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE

Robert Shkurt

